



Bordi i Zyrës së rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080”;
2. Dispozitat e Nenit 7 të Licencës për Gjenerim të Ngrohjes Qendrore të Termokos Sh.A;
3. Dispozitat e Nenit 18 të Licencës për Shpërndarje të Ngrohjes Qendrore Termokos Sh.A;
4. Kërkesat me shkrim të N.Q Termokos Sh.A të dërguar në ZRRE me datë 19.09.2008 dhe 24.03.2009, në seancën e mbajtur me datë 01 prill 2009, nxori këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET** kërkesa që për ekspert të pavarur të emërohet **Z. Fejzullah Krasniqi, Profesor i Fakultetit Teknik – Dega e Makinerisë në Prishtinë.**

1. N.Q Termokos Sh.A sipas Nenit 7 të Licencës për **Gjenerim** të ngrohjes qendrore, dhe Nenit 18 të Licencës së **Shpërndarjes** së ngrohjes qendrore, ka për obligim të caktojë ekspert të pavarur, emërimin e të cilëve do ta aprovojë ZRRE-ja.
2. Me 19.09.2008 dhe 24.03.2009 (sipas udhëzimeve të ZRRE-së) N.Q Termokos Sh.A ka kërkuar nga ZRRE të aprovojë kërkesën për emërimin e Z. Fejzullah Krasniqi, Profesor i Fakultetit Teknik – Dega e Makinerisë në Prishtinë, ekspert të pavarur.
3. ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e N.Q Termokos Sh.A dhe pas vlerësimit të biografisë së kandidatit ka aprovuar kërkesën që **Z. Fejzullah Krasniqi**, të jetë ekspert i pavarur i cili, në bazë vjetore, do të kryej kontrollin teknik dhe të sigurisë së njësisë **Gjeneruese** dhe asaj **Shpërndarëse** të N.Q Termokos Sh.A.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
5. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose data e publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit të tij ose datën e publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Bashkëngjitur: Biografia e Z. Fejzullah Krasniqi

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar